

# MARRËVESHJE FINANCIMI

## KUSHTE TË VEÇANTA

Komisioni Europian, këtu e më poshtë i quajtur "**Komisioni**"), duke vepruar në emër të Bashkimit Europian, këtu e më poshtë "**Unioni**",

nga njëra anë, dhe

Republika e Shqipërisë, këtu e më poshtë e quajtur "**Përfitues i IPA III**", e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave,

**nga ana tjetër,**

kanë rënë dakord si më poshtë:

### **Neni 1- Programi**

(1) Unioni pranon të financojë dhe përfituesi i IPA III bie dakord të pranojë financimin e Programit të mëposhtëm:

Programi Operacional Shumëvjeçar për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale në favor të Republikës së Shqipërisë për 2024-2027

që përfshin projektin e mëposhtëm:

Programi Operacional Shumëvjeçar për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale në favor të Republikës së Shqipërisë për 2024-2027

Numri global i angazhimit: JAD.1421641

Ky Program financohet nga buxheti i Unionit sipas aktit bazë të mëposhtëm: Instrumenti i Ndihmës para Aderimit (IPA III).<sup>1</sup>

(2) Kostoja totale e përlllogaritur e këtij Programi është 44. 000. 000 Euro dhe kontributi maksimal i Unionit për këtë Program është vendosur në shumën 30 000 000 euro.

Kontributi i Unionit do të ndahet në angazhime vjetore për periudhën 2024 – 2027 në përputhje me Aneksin I. Asnjë parashikim i kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të Unionit në lidhje me kreditë që nuk janë miratuar ende me miratimin e buxhetin të BE-së. Komisioni do të informojë me shkrim përfituesin e IPA III për miratimin e angazhimeve financiare të mëvonshme të treguara në Aneksin I.

Ky Program kërkon kontribut financiar si nga përfituesi i IPA III ashtu edhe nga Unioni. Ndarja e kontributeve financiare përkatëse është paraqitur në Aneksin I.

<sup>1</sup>Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 për krijimin e Instrumentit të Ndihmës Para-Aderimit (IPA III), OJ L 330, 20.9.2021, f. 1.

- (3) Programi do të zbatohet në përputhje me programin operacional shumëvjeçar të treguar në Aneksin I.

## **Neni 2- Periudha e ekzekutimit, periudha e pranueshmërisë dhe çlirimi i angazhimit**

- (1) Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financiare do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe do të përfundojë 12 vjet pas kësaj date.
- (2) Periudha e pranueshmërisë, siç përcaktohet në nenin 12(1) të Aneksit II (Kushtet e Përgjithshme) do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe do të përfundojë më 31 Dhjetor 2033.
- (3) Komisioni do të çlirojë automatikisht çdo pjesë të një angazhimi buxhetor për programin e treguar në Aneksin I e cila, deri më 31 dhjetor të vitit të pestë pas atij të angazhimit buxhetor, nuk është përdorur për qëllime të para-financimit ose kryerjes së pagesave të ndërmjetme, ose për të cilën nuk është paraqitur asnjë deklaratë shpenzimi e vërtetuar ose ndonjë kërkesë për pagesë.
- (4) Pa cenuar afatin automatik të çlirimit nga angazhimi i përmendur në paragrafin 3, Komisioni do të informojë përfituesin e IPA III 9 muaj përpara afatit automatik të çlirimit nga angazhimi për rrezikun e çlirimit nga angazhimi.
- (5) Shuma e prekur nga lirimi nga angazhimi do të reduktohet me shumat ekuivalente për atë pjesë të angazhimit buxhetor për të cilën:
  - (a) operacionet janë pezulluar me një proces ligjor ose me një ankim administrativ me efekt pezullues; ose
  - (b) nuk ka qenë e mundur të bëhet një kërkesë pagese për arsye të fatkeqësisë natyrore që ndikon seriozisht në zbatimin e të gjithë ose të një pjese të programit.  
Përfituesi i IPA III që pretendon për fatkeqësinë natyrore duhet të tregojë pasojat e drejtpërdrejta të fatkeqësisë natyrore mbi zbatimin e të gjithë ose të një pjese të programit.

## **Neni 3 - Adresat dhe komunikimi**

Të gjitha komunikimet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare do të bëhen me shkrim, do t'i referohen shprehimisht Programit siç është identifikuar në nenin 1(1) dhe do të dërgohen në adresat e mëposhtme:

### **(a) për Komisionin**

Valentina Superti  
Director D, Western Balkans  
Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations (DG NEAR)  
European Commission  
Rue de la Loi 15  
B-1049 Brussels, Belgium  
E-mail: [NEAR-D@ec.europa.eu](mailto:NEAR-D@ec.europa.eu)

### **(b) për përfituesin e IPA III**

Eridana Çano  
Koordinatori Kombëtar për IPA-n  
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës  
Rruga "Kuvajt"  
Tiranë, Shqipëri  
E-mail: [eridana.cano@saspac.gov.al](mailto:eridana.cano@saspac.gov.al)

#### **Neni 4 - Pika e Kontaktit në OLAF**

Pika e kontaktit e përfituesit të IPA III që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) për të lehtësuar aktivitetet operacionale të OLAF-it është:

Blerina Naska  
Drejtor i Njësisë së Inspektimit Financiar pranë Drejtorisë së Inspektimit të Financave Publike në Ministrinë e Financave  
Ministria e Financave  
Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr.3  
Tiranë, Shqipëri  
E-mail: [blerina.naska@financa.gov.al](mailto:blerina.naska@financa.gov.al)

#### **Neni 5 - Marrëveshje kornizë e partneritetit financiar**

Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kornizë të Partneritetit Financiar (FFPA) ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë mbi organizimet për realizimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Shqipërisë sipas Instrumentit të Ndhmës para-Aderimit (IPA III) e cili hyri në fuqi më 14 tetor 2022 (më tej e quajtur "FFPA"). Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e FFPA. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe dispozitave të FFPA, kjo e fundit do të ketë epërsi.

#### **Neni 6 – Aneksat**

- (1) Kjo Marrëveshje financimi përbëhet nga:
  - (a) këto Kushte të Veçanta
  - (b) Aneksi I: Programi Operacional Shumëvjeçar
  - (c) Aneksi II: Kushte të përgjithshme
  - (d) Aneksi III: Model Raporti Vjetor për zbatimin e ndihmës IPA III sipas nenit 59 të FFPA
  - (e) Aneksi IV: Model Raporti Financiar sipas nenit 61(2)(a) dhe 61(3) të FFPA, duke përfshirë modelin e parashikimeve për kërkesat e mundshme të pagesave sipas nenit 33(3) të FFPA
  - (f) Aneksi V: Specifikimet Minimale të Sistemit Kontabël me bazë rritëse

- (g) Aneksi VI: Model Aplikimi për Projekte Madhore
- (2) Aneksi VII: Model Konstatimi i Veprimeve
- (3) Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Anekseve dhe dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë epërsi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të Aneksit I dhe dispozitave të Aneksit II, këto të fundit do të kenë epërsi.

## Neni 7 - Dispozita që shmangin ose plotësojnë Aneksin II

Sa më poshtë plotësojnë Aneksin II:

- (1) Pas vlerësimit pozitiv të misionit verifikues për dhënien e detyrave të zbatimit të buxhetit, të kryer nga DG NEAR në qershor 2024, një mision pasues do të kryhet nga DG NEAR në vitin 2025 për të verifikuar që linjat e komunikimit ndërmjet Zyrtarit Kombëtar Autorizues (NAO), Zyrës Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (NAOSO) dhe Organit Kontabël (AB) të mbeten të formalizuara dhe të drejtpërdrejta siç kërkohet nga IPA III FFPA. Kjo do të jetë një shtesë për gjetjet e raportit përfundimtar të auditit, të cilat kërkojnë një ndjekje në përputhje me afatet kohore të përcaktuara për çdo gjetje.
- (2) Komisioni ka prezantuar një sistem shkëmbimi elektronik për raportimin e kontratave nën menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III ("IPA-APP"). Përfituesit të IPA III i kërkohet të regjistrohet dhe të përdorë IPA-APP për të lejuar menaxhimin elektronik të Marrëveshjeve të Financimit.

## Neni 8 - Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën në të cilën Komisioni merr një njoftim nga përfituesi i IPA III që konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të përfituesit të IPA III të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni do të informojë përfituesin e IPA III për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje Financimi është bërë në dy kopje në gjuhën angleze, njëra i dorëzohet Komisionit dhe tjetra përfituesit të IPA III.

Për përfituesin e IPA III:

Për Komisionin

Eridana Çano  
Koordinator Kombëtar për IPA dhe Drejtor i  
Përgjithshëm  
Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik  
dhe Koordinimit të Ndihmës  
Tiranë,

Valentina Superti  
Director D, Western Balkans  
Directorate-General for Neighbourhood and  
Enlargement Negotiations  
European Commission  
Brussels,

Data:

Data:

Nënshkrimi:

Nënshkrimi: